



## **RELACION TEKNIK**

### **NDËRTIM I AMBJENTEVE SPORTIVE SHKOLLA 'ADEM HAXHIJA' (Jeto me sportin)**

**Shkoder 2024**

## I. HYRJE

Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore, është një ndër prioritetet kryesore të Bashkisë Shkodër.

Rikualifikimi i objekteve me funksione arsimore dhe rikonceptimi i tyre, ku përdorimi të mos jetë i kufizuar vetëm gjatë orarit të punës, por ti shërbejë si punonjësve ashtu edhe komunitetit, kërkon një ndërhyrje emergjente, në përputhje me nevojat specifike të çdo institucioni.

Vizioni i Bashkisë Shkodër është transformimi i territorit në një hapësirë politcentrike që ofron shërbime më të njëjtin standard për publikun në mënyrë të thjeshtë dhe të aksesueshme nga banorët dhe vizitorët. Ndërtimi i komplekseve sportive stërvitore, është kusht për rritjen e cilësisë sportive. Krijimi i ambjenteve sportive synon promovimin e sportit si instrument edukues dhe burim shëndeti për komunitetin.

Projekti synon të përfshijë të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke ofruar shërbimin me të njëjtin standard, si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale, duke nxitur përfshirjen e komunitetit në zhvillimin e aktiviteteve sportive.

## II. GJENDJA AKTUALE E OBJEKTIT

### Vendndodhja

Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla Adem Haxhija ndodhet në njësinë administrative Postribe, rr. “Mes Ura e Shtrejte, me numër pasurie 437/54, Z.K. 1240.


Në shkollën e mesme të bashkuar ‘Adem Haxhija’ mesojnë 466 nxënës dhe punojnë 33 mësues.





## Problematikat e infrastrukturës ekzistuese


Sheshi i ndërtesës, me një sipërfaqe rreth 8000 m<sup>2</sup>, aktualisht nuk mund të shfrytëzohet për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e sheshit është e pashtuar, një pjesë e madhe e terrenit ku zhvillohet aktivitetet sportive është në gjendje jo të mirë gjë që pengojnë në ushtrimin e normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht sheshi është i papërshtatshme për çdo aktivitet sportiv dhe rekreativ.




### III. REALIZIMI PROJEKTIT

#### Objektivi


Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Bashkisë Shkodër duke i mundësuar çdo fëmije, të riut dhe të reje që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare nëpërmjet pjesmarrjes aktive në aktivitetet sportive. Është menduar që të krijohen 2 fusha basketbolli që do të shërbejnë dhe për volejboll, gjithashtu dhe një fushe kalçeto me përmasa 40 x 20 m.




Ndërtimi i ambienteve sportive të reja si dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për stërvitje, synon rritjen e numrit të sportistëve dhe cilësisë së tyre Fusha e basketbollit / volejbollit me dimensione: 28m x 15m si dhe fusha e kalçetos me dimensione: 40x 20 m e cila do te rrethohet me rrjete. Është menduar që fusha ku mund të luhen sporti i basketbollit ose volejbollit dhe kalçetos të paiset me 250 vende për qëndrimin e s spektatorëve. Shtresa e fushes se futbollit do te jetë me tapet bari artificial, ndersa shtresa e fushave te basketbollit / volejbollit jane me primer+shtresë rere silice +veshje poliuretani me ngjyre.



DETAJ RRJETE VOLEJBOLLI SH 1:150



### Detaj fushe basketbolli



Rimodelimi i të gjithë sheshit, si para ndërtesës, ashtu edhe pas saj, e kthen në një hapësirë multi funksionale. Në sheshin përpara ndërtesës është menduar krijimi i një hapësire rekreative, hapësirë kjo e cila mund të përdoret si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhet Shkolla

Ing Florinda Hilaj  
Ing . Viktor Sheldija